




**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE**



Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së pestë - V-të, të rregullt të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 25.06.2020, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Sabri Rexhepi, Ali Zogjani, Durim Hajra, Doruntina Jashari, Eglantina Azemi, Aida Alimi, Arjana Zogjani, Naser Graiçevci, Migjen Kolshi, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Mehdi Lahu, Shaban Ademi, Mensur Grajqevci, Hysni Hasani, Suhat Ademi dhe Ljubisa Qirkoviq.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkryetar i Komunës, Nuriye Fazliju - Drejtoreshë e Administratës, Abdullah Prebreza - Drejtor i Planifikimit Urban, Ramadan Jashanica - Drejtor i Financave e Buxhetit, Islam Shabani - Drejtor i Arsimit, Ekrem Berjani - Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Jakup Dumani - Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Maliq Berisha - Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.

Të tjerë: Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 04.06.2020.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2021-2023.
4. Informatë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019.
5. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të menaxhimit të gjendjes emergjente shëndetësore për parandalimin e përhapjes së pandemisë së Coronavirusit COVID - 19 në Komunën e Fushë-Kosovës.
6. Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në mbledhjen e sotme dhe pikën shtesë: Raportin e shpenzimeve të menaxhimit të gjendjes emergjente shëndetësore për parandalimin e përhapjes së pandemisë së Coronavirusit COVID - 19 në Komunën e Fushë-Kosovës, të cilën anëtarët e Kuvendit të Komunës e keni marrë dje në mënyrë elektronike. Hap diskutimin.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim rendin e ditës me pikën shtesë për këtë mbledhje: Raportin e shpenzimeve të menaxhimit të gjendjes emergjente shëndetësore për parandalimin e përhapjes së pandemisë së Coronavirusit COVID - 19 në Komunën e Fushë-Kosovës.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm.
Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar me pikën shtesë.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e dates 04.06.2020.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për aprovim 'ekstraktin e procesverbalin nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 04.06.2020'. Hap diskutimin për vërejtjet dhe sugjerimet tuaja.

Pasi që vërejtje apo sugjerime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 04.06.2020'.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', tetë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 04.06.2020.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'pyetje dhe përgjigje parlamentare', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të parashtrojnë për Ekzekutivin e Komunës nëse kanë ndonjë pyetje.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje lidhur me furnizimin me ujë të pishëm nëpër fshatrat e komunës tonë, sepse ujë është mbrojtje dhe pastërti për njerëzit, në këtë kohë të vështirë të pandemisë, për të mos i përsëritur në vazhdimësi fjalët e njëjta që i kemi thënë, shkurt uji është edhe e drejtë e secilit njeri. Edhe pse është lidhur gypi i ujit në fabrikën e Shkabajt, një pjesë e lagjes së Nakaradës nuk ka ujë të pishëm?

Nënkryetari i Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani furnizimi në fshatin Bardh i Madh është i mirë, kur flisni z. Durim Hajra, ju duhet të folni me emër për fshatin apo lagjen e caktuar.

Durim Hajra: Nga rrethi e poshtë rrugës kryesore ndriçimi publik është problem, në rrugën 'Haxhi Zeka', ku janë disa shtëpi të pabanueshme që janë bërë strehë për qentë endacakë. Tjetër pyetje ujërat e zeza në rrugën 'Jusuf Gërvalla' në fshatin Pomozotin janë problem? Kryetari i Komunës ka premtuar se do ta rregullon rrugën 'Dardania' në Fushë-Kosovë, aty shqetësim për qytetarët është ndotja akustike, zhurma është në nivel të lartë dhe duhet të monitorohet nga organet kompetente policia dhe inspektorati duhet të jenë më azhur në teren, bëhet shumë zhurmë, nuk ka zgjidhje as për parkingje?

Shaban Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë do t'i ngris për diskutim dy çështje që janë pak kritikë, pak sugjerime. Disa zgjidhje në teren i bënë Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, sepse Drejtoria e Inspektoratit nuk vepron, këtu dua ta falënderoi drejtorin z. Maliq Berisha, të cilin kur e kemi thirrur na ka ofruar zgjidhje, bora është hequr gjatë sezonit dimërorë, me telefon e kemi kryerë punën. Në kohën e fundit është mbyllur rrjeti i kanalizimit, ujërat e zeza kanë vërshuar nëpër oborre, përgjigjëja ka qenë me keqëardhje nuk kemi kontratë me Kompaninë,

andaj nuk mund të intervenojmë. Ky drejtor është shembull, por kur ka problem burokratike vonesa të panevojshme, për punë të vogla, unë mendoj se nuk ka nevojë të shtrohen shumë çështje në Kuvendin e Komunës, shumë gjëra mund t'i zgjidhim lehtë me komunikim direkt. Unë tani jam para pensionit, veprimet duhet të merren me kohë, të bëhen zëvendësimet e njerëzve, edhe tenderët duhet të shpallen dy muaj përpara, sepse na mbulon bora, tjetër mund të ketë edhe ankesa në procesin e tenderimit dhe këto procedura zgjasin, andaj duhet të veprojmë me kohë. Ne nuk e dimë kush vepron në Inspektorat, e dimë që këtë punë deri vonë e ka kryerë Nënkryetari i Komunës, me letra Drejtor i Inspektoratit është z. Afrim Krasniqi, por kjo punë neve dhe qytetarëve nuk na intereson, puna duhet të kryhet, të mbikëqyret gjendja në teren, projektet publike që realizohen të mbikëqyren si po kryhen. Tani në rrugën 'Avdyl Henci' janë tri biznese të reja në anën e djathtë të rrugës, aty është krijuar një kanal i gjerë, ku kanë vërshtuar ujërat sipërfaqësore, ne shumica që vijmë nga fshati Henc, Remziu dhe Dritoni e njohim atë teren, këto ujëra derdhen në 'Zanogë'. Asfalti aty është shtruar nën nivel, në rrugët dytësore nuk janë vendosur gypa, tani aty përrocka e 'Zanogës' vërshon, unë ju sugjeroi që puna në teren duhet të bëhet, edhe bizneset duhet t'iu përmbahen rregullave, të kontrollohen, projektet duhet të bëhen në mënyrë profesionale, ose dikush këtu është i korruptuar.

Eglantina Azemi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kryetari i Komunës në fushatën zgjedhore e ka premtuar që rruga e 'Dardanisë' në Fushë-Kosovë, do të jetë rrugë njëkahore, po ashtu e ka premtuar një park aty, andaj qytetarët e kërkojnë realizimin e kërkesave të tyre legjitime, për një park dhe rregullimin e komunikacionit.

Naser Graiçevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë do të flas tani për dy çështje, situatë që janë krijuar tani, për momentin prioritet duhet të jetë uji si produkt i domosdoshëm për qytetarët në kohën e pandemisë dhe ne si Kuvend i Komunës në vijën vertikale të dalim me një deklaratë të përkrahjes për Presidentin e Republikës së Kosovës, sepse ai është një titull, jo si individë, mendoj ne si kuvend lokal duhet të bëjmë këtë. Po ashtu unë kërkoj, që sektori i punëtorëve të pastrimit të përfshihen në ndihmat shtesë, sepse Qeveria e Kosovës nuk i ka përkrahur. Ky sektorë në këtë kohë ta pandemisë ka qenë pika më e ndritshme, e ka mbajtur qytetin tonë të pastër, andaj kërkoj që Drejtoria e Financave dhe Buxhetit të gjen mundësinë për përkrahjen e tyre.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Për pyetjet e parashtruara nga mbledhja e kaluar unë nuk kam marrë përgjigje, andaj duhet t'i përsëris ato, është fjala lidhur me vendimin për rrënimin e objektit Bellavista i datës 12.19.2019, lënda është në gjykatë, ndërsa me datën 24.02.2020 kësaj pale i është dhënë një pëlqim, ne nuk e dimë çka ka plotësuar pala në fjalë. Vendimi tjetër është për objektin pas pompës së benzinës me pronar Besim Bujupi për objektin me etazhitet B+P+E+NK edhe kjo lëndë është në gjykatë, ne e kemi të kontraktuar Kompaninë për rrënimin e objekteve pa leje. Po ashtu edhe në fshatin Vragoli, subjekti afarist 'Made in Kosova', e ka vendimin për rrënim, pronar është me emrin Bedri, ndërsa ai po e vazhdon punën. Lidhur me furnizimin me barna do të flas te 'raporti i shpenzimeve për pandeminë'. Për zhavor prap po ndahet shuma prej 120,000.00€ në kohën e pandemisë, kjo i bjen të blihen gjithsej 800 kamiona me zhavor, pyes ku po shtrohen këto rrugë me zhavor?

Mehdi Lahu: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Për të mos i përsëritur pyetjet e njëjta, unë po ndalem vetëm tek mbjellja e pemëve dekorative në rrugën kryesore, duhet të bëhet zëvendësimi i tyre, sepse 80% e tyre janë tharë, nëse ato thahen atëherë, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit nuk duhet ta bëjë mbjelljen e tyre fare.

Aida Alimi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e mbështesë kërkesën e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Naser Graiçevci, që ne si Kuvend i Komunës ta përkrahim përmes një deklarate Presidentin e Republikës së Kosovës. Inspektorati i Komunës duhet ta bënë mbikëqyrjen e projekteve publike, ato nuk duhet të pranohen nga Komisionet Komunale, pa i përmbushur kushtet teknike, ne po kemi shumë ankesa të qytetarëve për punët e kryera në teren. Unë Drejtoreshën e Administratës e pyes, kur do të funksionalizohen mikrofonat në sallën e Kuvendit të Komunës?

Driton Hasolli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Edhe unë e përkrah znj. Aida Alimi lidhur me mikrofonat dhe në shenjë proteste unë nuk dal sot në foltore për diskutim, mos rregullimi i mikrofonave për një kohë kaq të gjatë është i pa arsyeshëm. Kërkoj që rruga kryesore nga laura në fshatin Pomozotin deri te objekti i 'Dacit' janë krijuar gropa të mëdha, propozoi që kjo gjendje të sanohet në atë rrugë. Po ashtu për arsye të rritjes së barit në disa zona buzë rrugës kryesore dhe rrugës për Kuzmin, dukshmëria në rrugë është vështërsuar dhe mund të shkaktohen aksidente në trafik, kërkoj nga përgjegjësitë që të ndërmerren masa në këtë drejtim.

Sabit Bullatovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë i kam disa pyetje për Drejtorinë e Bujqësisë e Zhvillimit Rural dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit për mbjelljen e drunjëve dekorativ në rrugën magjistrale M9, njerëzit kalojnë nga njëra anë e rrugës në tjetrën në qendër të qytetit, aty janë mbjellur dardha të egëra, kjo nuk ka logjikë, mua si kalimtarë kjo ma ka vrarë syrin. E nderuara znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës, unë kam vërejtje për emërtimin e rrugëve në fshatin Miradi e Poshtme, në bazë të cilave kritere janë emërtuar këto rrugë, kam vërejtje për Kryetarin e Komisionit z. Maliq Berisha, tani Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës duhet të na sjellë hartën, për secilin vendbanim dhe qytetin e Fushë-Kosovës, me situacionin e emërtimeve të rrugëve ekzistuese. Te ne është bërë zgjerimi i qytetit me banorë të rinj, janë krijuar lagje të reja, rrugë të reja, popullata kërkon që këto rrugë të emërtohen me emra të ri, ne duhet të punojmë në këtë drejtim. Në fshatin tim nga 28 rrugë gjithsej vetëm 5 rrugë janë emërtuar si duhet, në qytet nga skica e kaluar kanë qenë 154 rrugë, e kemi ortofoton, duhet të punojmë me hartë dhe ortofoto, këto sot na mundëson teknologjia.

Mirvete Gërguri: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani mua më befasoi z. Durim Hajra me konstatimin që në fshatin Bardh i Madh ka ujë të pishëm, ta dimë këtë fakt dhe t'i ç'kuqim hidroforët, sepse uji është çështje jetike për qytetarët. Çfarë do të bëhet me fatin e banorëve të ndërtesës përballë komunës, sepse ata po kërkojnë të dine, a do të investohet nga komuna në këtë ndërtesa. Pyes, në planet buxhetore për ndërtimin e urave, a do të ndërtohet ura e re në fshatin Bardh i Madh, e cila është shumë e vjetëruar dhe paraqet rrezikë për banorët që kalojnë në këtë urë të vjetër. Në rrugën kryesore duhet të rregullohet ndriçimi publik, gjatë muajve të kaluar punëtorët e Kompanisë së mbeturinave 'Pastrimi', e kanë mbajtur pastërtinë në nivelin e duhur, bërllogu hiqet vazhdimisht në rrugën Bardh i Madh/Kuzmin/Fushë-Kosovë, por dikush prap e hedh bërllogun në atë zonë. Unë mendoi se duhet të mendohet që të punësohen edhe femrat nëpër kompani rajonale. Unë dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kam kërkuar që komuna jonë të aplikon për përfitimin e fondeve për energjinë efiçiente, aplikimi është i hapur deri me datën 30 qershor, kushtet për përfitimin e këtyre granteve është plani komunal për energji efiçiente, planifikohet të jepen grante për ndriçime në rrugë, objekte publike, ku vlerësohet shpenzimi i energjisë në tri vitet e fundit. Në komitet u tha se na çdoherë konkurojmë, por asnjëherë nuk na ndahen këto grante, unë mendoi se duhet të punojmë për plotësimin e kushteve për aplikim

sipas kërkesave të donatorëve. Unë jam e gatshme që ta jap edhe ndihmën time në këtë drejtim. Duhet ta kemi një studim pse po thahen pemët, a po mbillen ato në vende të pa përshtatshme, ka nodhur në një komunë tjetër në Suharekë, është menduar se pemët janë tharë, por kur i janë hequr llastikun, pema ka qenë e njomë, duhet të mbikëqyret mbjellja e tyre. Ne duhet të veprojmë brenda afatit garantues të kontratës, menaxheri i kontratës duhet të përcjellë këtë punë.

Jetmir Berisha: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë e mbështesë propozimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Naser Graiçevci që të përkrahen financiarisht punëtorët e Kompanisë 'Pastrimi', nga pako emërgjente e Qeverisë së Kosovës ne jemi përjashtuar, edhe pse punëtorët e kanë bërë një punë të jashtëzakonshme dhe e kanë ruajtur shëndetin e qytetarëve, duke e mbajtur ambientin të pastër. Ne shpresojmë që Qeveria e re do të na përkrah, sepse punëtorët kanë punuar në tri ndërrime gjatë kohës së pandemisë, i kanë merituar tri paga shtesë, kanë qenë të rrezikuar, ne e kemi shprehur edhe revoltën tonë përmes protestës, ne vendet evropiane punëtorët e pastrimit janë shumë të vlerësuar dhe përkrahur nga shtetet e tyre. Komuna jonë na ka ndihmuar me dorëza dhe alkohol në fillim dhe pako ushqimore për punëtorët tanë dyherë, për këtë ndihmë e falënderojmë Kryetarin e Komunës. Unë i ftoi kolegët e mi që ta përkrahin propozimin për ndihmë për punëtorët e 'Pastrimit', me aq sa ka mundësi nga buxheti i komunës. Unë nuk flas këtu për vete, por së paku punëtorët fizik të terrenit të shpërblehen, mjekët i kanë patur pajisjet mbrojtëse për punë, punëtorët tonë në teren i janë ekspozuar rrezikut. Komunitet tjerë këta punëtorë i kanë shpërblyerë, sepse këta me pagën e tyre e mbajnë familjen. Lidhur me gjendjen e keqe me ujë në fshatrat: Graboc i Poshtëm dhe Bardh i Madh që u cekë nga kolegët znj. Mirvete dhe z. Durimi, ju njoftoj se gypi në fshatin Graboc i Poshtëm është sanuar, ndërsa në fshatin Bardh i Madh gypi ekzistues e ka një kosto të lartë financiare për funksionalizimin e tij, mirëpo çështja e ujit është jetike për banorët dhe duhet të zgjidhet si problem.

Ali Ismaili: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Drejtoritë e Komunës po na japin përgjigje gjysmake, lidhur me çështjet e ngritura nga ne, e tillë ka qenë në mbledhjen e kaluar përgjigjja e Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefes së Drejtorisë së Arsimit. Nga ajo përgjigjeje e Shefes së Drejtorisë së Arsimit, pak kam kuptuar për ndihmën për nxënësit që nuk kanë patur mundësi të ndjekin mësimin online. Unë i di vështirësitë e ndëruara znj. Kryesueses e Kuvendit të Komunës, sepse edhe ju punoni në arsim, disa nxënës kanë patur problem për pjesëmarrje aktive në mësimin online, mësimdhënësit kanë punuar me mundësitë që i ka ofruar teknologjia, si përmes viberit, zoomit e tjera, por nxënësit e familjeve skamnore kanë patur probleme të theksuara. Tani jemi në fund të vitit shkollor, duhet të mbyllem notat, si do të veprohet nëpër shkollat tona, a kanë udhëzime mësimdhënësit për hapat që duhet t'i ndjekin.

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, lidhur me ujin e pishëm, në lagjen 028 dhe 029, ne rrjetin e kemi, por ujë nuk ka. Planifikohen të bëhen asfaltime nëpër rrugë në fshatra, te ne janë të pa asfaltuara tri rrugë, për të cilat kërkojmë që të asfaltohen. Në lagjen tonë kemi nevojë për një trafo të re, shtyllat janë të vendosura, por ndriçim nuk ka. Në lagjen e hekurudhës, rruga 'Mëshari', nga statcioni i trenit deri në fund të rrugës kur bjen shi vërshon kanalizimi, kërkoj që të intervenohet për rregullimin e tij.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Lidhur me ujin e pishëm z. Durim Hajra keni të drejtë, para pak muajve ne kemi patur një takim me përfaqësuesit e Ujësjellësit, unë, Kryetari i Komunës dhe Nënkryetari i Komunës për rregullimin

e ujit në periferi të qytetit dhe nëpër fshatra, por ndodhi pandemia dhe procesi ka ngecur tani, shqetësim tjetër, i ngritur nga ju tani është ndriçimi publik në rrugën 'Haxhi Zeka', tani unë i dërgova një mesazh, Kompanisë punëkryese dhe kjo punë do të rregullohet. Lidhur me ujërat e zeza në fshatin Pomozotin, tani jemi në hendikep të madh, sepse ka skaduar kontrata e vjetër dhe ende nuk është lidhur kontrata e re me operatorin ekonomik, problem të njëjta kemi edhe në fshatrat: Harilaç, Henc dhe dy Sllatina, sepse kemi ankesa në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Lidhur me problemin në banesat përballë, është një zonjë që me mua komunikon shumë rëndë, pa asnjë të drejtë, por ne nuk mund të ofrojmë zgjidhje pa nënshkrimin e kontratës së re. Ne kemi problem sepse Kompania e Ujësjellësit Rajonal 'KUR Prishtina' nuk ka njësi në Komunën e Fushë-Kosovës dhe problemet kanë më pak mundësi reale të zgjidhen. Me anëtarin e Kuvendit të Komunës z. Shaban Ademi jemi sqaruar, nuk kemi mundur të intervenojmë sepse nuk kemi kontratë valide tani. Për zhavorin janë të planifikuara shuma e mjeteve financiare prej 120,000.00€, por kërkesat për shtruarjen e rrugëve në Drejtorinë tonë janë të mëdha nga qytetarët. Pemët dekorative në Fushë-Kosovë, ju po thuani se janë tharë 80%, kjo nuk është e vërtetë, janë disa defekte të vogla, por këto pemë rigjenerohen, nëse një lloj i pemëve nuk përshtatet, duhet ta ndërrojmë. Lidhur me emërtimet e rrugëve që u cekë nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Sabit Bullatovci, unë e kam një kërkesë dhe dua të sqaroj, se unë në Komisionin e kaluar nuk kam qenë i privilegjuar aty, kam qenë vetëm njëri nga anëtarët e Komisionit, në mesin e të barabartëve, vendimet për listën e rrugëve janë marrë me konsensus. Pastrimin e barit nëpër hapësira publike ne nuk mund ta bëjmë, rrugët janë në kompetencë të Ministrive, ne e kemi bërë pastrimin e barit nëpër varreza, nëpër shkollat tona. Rruga e fshatit Kuzmin është pak e ndieshme, ne e kemi bërë edhe gardhimin aty, por jemi paditur si komunë, aty e kemi pastruar zonën disa herë. Për lagjen 028, ne nuk e shtrojmë rrjetin e kanalizimeve dhe as nuk asfaltojmë rrugë, detyrë e jona si Drejtori është vetëm mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit. Rregullimin e trafave ne nuk mund ta bëjmë, sepse tani kjo pjesë e Korporatës Energjetike të Kosovës është privatizuar, ne i kemi ndihmuar më herët disa zona, por tani nuk kemi të drejtë ligjore ta bëjmë këtë punë. Ndriçimi publik është në fazën e tenderimit, ne besojmë se gjatë këtij viti do t'i ndriçojmë shumicën e rrugëve në Fushë-Kosovë.

Drejtori për Arsim: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë jam informuar për përgjigjen që e keni marrë nga Shefja e Drejtorisë për Arsim znj. Elmije Zymberi, tani dua të jem i shkurtër, me datën 11 mars 2020, me rekomandimin e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik janë mbyllur shkollat, unë në fillim i kam marrë masat e para në konsultim me drejtorët e shkollave, sepse është para se kjo punë do të zgjatë, me datën 23 mars ka filluar mësimi online, ne në komunën tonë i kemi shfrytëzuar edhe platformat tjera si: zoomin, vatsapin, viberin, e tjera. Në shkollat fillore kemi patur një bashkëpunim të mirë me Këshillin e Prindërve, të cilët kanë qenë shumë aktivë. Përveç mësimi online në televizion, mësimdhënësit tonë kanë përdorur edhe platforma tjera të teknologjisë informative për komunikim direkt me nxënësit. Kompania 'Elkos' e pronarit z. Ramiz Kelmendi na ka ndihmuar me 12 lloptopë, prej tyre 9 u janë ndarë nxënësve nga radhët e komuniteteve romë, ashkalinj dhe egjiptian, ndërsa vetëm 3 u janë ndarë nxënësve shqiptarë. Tani sekretarja e shkollës 'Mihal Grameno' ka dalur pozitiv në testin për virusin Covid - 19, ajo ka patur kontakt së paku me 52 persona në shkollë, të cilët janë në vetëizolim, ju duhet të dini se kjo shkollë i ka gjithsej 106 arsimtarë. Ne do ta përcjellim situatën dhe do ta gjejmë një mënyrë të veprimit për shkollën në fjalë.

Hysni Hasani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani nxënësit e komuniteteve nga lagjia 028 dhe 029, janë të detyruar të shkojnë në dy shkolla në Fushë-Kosovë 'Selman Riza' dhe 'Daut Bogujevci', nxënësit nuk duhet të ndahen, pastaj kemi edhe raste të braktisjes së shkollës nga nxënësit e komuniteteve.

Drejtori për Arsim: Nga Kuvendi i Komunës është themeluar një Komision, ku pjesëmarrës kanë qenë mbi 15 persona, drejtorët e shkollave, përfaqësues të komuniteteve. Komisioni në fjalë e ka bërë sistemimin e nxënësve sipas rrugëve nëpër shkolla. Tani në shkollën 'Selman Riza', numri i nxënësve nga radhët e komuniteteve është zvogëluar për vetëm 100 nxënës.

Hysni Hasani: Më herët në klasën e parë janë regjistruar rreth 130 nxënës nga radhët e komuniteteve, tani nuk janë regjistruar as 40 nxënës.

Drejtori për Arsim: Ne e kemi bërë maksimumin i kemi thirrë prindërit, por interesimi i tyre është shumë i vogël, por e kemi edhe muajin gusht ku nxënësit mund të regjistrohen në shkollë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Është një dukuri jo e mirë, sepse komunitetet regjistrimin në shkollë e bëjnë në muajin shtator.

Doruntina Jashari: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pyes, pse konkursi për Zëvendësdrejtor të Shkollës se mesme teknike 'Minatori' është shpallur katër herë.

Drejtori për Arsim: Ky konkurs është anuluar dy herë, sepse nuk kanë qenë tre aplikues, kjo është e vërteta.

Nënkryetari i Komunës: Me 'Planin e mobilitetit për rregullimin e trafikut', i cili është në proces, shumë rrugë do të jenë njëkahore, do të ofrohet zgjidhje edhe për rrugën e 'Dardanisë' e cila është më e frekuentuar nga qytetarët. Lidhur me kërkesën e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Naser Graiçevci, opinion im është, se ne si Kuvend Komunal nuk kemi nevojë të bëjmë ndonjë deklaratë, kjo është punë e nivelit qendrorë, madje kjo punë ligjërisht mund të zgjatë deri në muajin tetor, kjo është punë e institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës.

Pika e tretë (3) - Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2021-2023.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2021-2023', ku parashihen ndarjet buxhetore për administratë, arsim dhe shëndetësi, të hyrat vetjake dhe projektet kapitale për vitin 2021, si dhe vlerësimet e hershme për vitet 2022 dhe 2023. Ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Buxheti është hartuar në bazë të Qarkores buxhetore të Ministrisë së Financave dhe Transfereve Nr. 1, deri me datën 08.06.2020, secila Drejtori e Komunës e ka patur mundësinë të propozon ndryshime. Në këtë kornizë buxhetore parashihen shpenzimet për numrin e të punësuarëve, për kategoritë ekonomike: paga dhe mëditje, mallëra e shërbime, komunali, subvencione e transfere, të hyrat vetjake dhe në fund shpenzimet për projektet kapitale. Ky buxhet mund të ndryshohet me Qarkoren buxhetore Nr. 2 dhe deri në fund të muajit shtator 2020 duhet të miratohet në Kuvendin e Komunës. Ne i kemi paraparë edhe tri dëgjime buxhetore me qytetarë me datë: 3 korrik, 24 korrik dhe 28 gusht dhe ju ftoi që të merrni pjesë. Në tabelën numër dy është shpërndarja e grantit të përgjithshëm për vitet 2020-2023, granti i përgjithshëm për administratë është në shumë të mjetëve financiare prej: 3,678,702.00€ dhe është më i ulët për shumën prej: 110,000.00€, granti për arsim në shumë prej:

3,524,120.00€ dhe më i ulët për shumën prej: 1,286,000.00€, ndërsa granti për shëndetësi është në shumë prej: 1,251,487.00€ dhe më i lartë për shumën prej: 52,000.00€. Buxheti i këtij viti është në shumë prej: 12,608,366.00€, ndërsa për vitin e ardhshëm është në shumë prej: 11,263,819.00€, ose më i ulët për shumën prej: 1.3 milion euro më pak mjete financiare në dispozicion. Në tabelën numër tre është granti qeveritar në shumën prej: 8,247,309.00€ dhe të hyrat vetjake në shumën prej: 2,809,510.00€. Në tabelën numër pesë janë programet dhe nënprogramet, i kemi patur 772 punëtorë, kemi kërkuar 794 punëtorë, prej tyre dhjetë në shëndetësi, dhjetë në arsim dhe dy në çerdhe. Mjetet financiare për kategoritë ekonomike janë si vijon: për paga dhe mëditje në shumë prej: 5,096,345.00€, për mallëra dhe shërbime në shumë prej: 1,712,670.00€, për komunalitë në shumë prej: 250,000.00€, për subvencione dhe transfere në shumë prej: 355,000.00€ dhe për investime kapitale në shumë prej: 3,849,804.00€ edhe tani por edhe gjatë debateve publike për buxhetin e vitit 2021.

Durim Hajra: Korniza Afatmesme Buxhetore për vitet 2021-2023 caktohet në bazë të objektivave të komunës, matjeve buxhetore për projekte të caktuara publike, unë do të ndalem në katër prej gjithsej nëntë objektivave të kësaj kornize buxhetore. Objektive imediate tani në këtë kohë duhet të jetë ambienti, objektiva e dytë infrastruktura e komunës, pastaj te Kultura, Rinia dhe Sporti nuk është përfshirë asgjë në buxhet për rininë, asnjë projekt i mirëfilltë. Shtëpia e Kulturës në komunën tonë është në gjendje të mjerueshme, në buxhet nuk parashihet as renovimi, as ndërtimi i ndonjë Qendre të re kulturore, nuk ka as investime serioze në sport, p.sh. në futboll ku grumbullohen rinia jonë. Nuk ka asnjë projekt për rininë në fshatrat e mëdha, funksionon vetëm Ansambli i cili nuk është duke e bërë namin krahasuar me përkrahjen që i jepet. Ne propozojmë që të ndërtohet një Qendër sociale për rininë. Për uljen e papunësisë nuk është menduar fare, punësohen vetëm njerëzit që kanë lidhje politike. Parashihet të zhvillimi i turizmit malor disa projekte, ne do t'i ofrojmë propozimet tona edhe gjatë diskutimeve publike, edhe në formën e shkruar, por ato nuk po merren parasysh nga Ekzekutivi i Komunës. Tjetër duke e patur parasysh, uljen e buxhetit për vitin 2021, prap parashihen mjete financiare për asfaltim një shumë prej: 505,000.00€ dhe shuma prej: 120,000.00€ për shtruarjen e rrugëve me zhavor, shuma prej: 300,000.00€ për ndërtimin e shtëpive, shuma prej 50,000.00€ për renovimin e shtëpive, pra plotë 1.3 milion euro shkojnë në këtë drejtim, pa ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore, tani kur jemi në kohën e pandemisë, e cila po zgjat dhe pasojat e saj për ekonominë e vendit do të shihen edhe në vitin e ardhshëm. Ky buxhet është një kopje e buxhetit nga vitet e kaluara, me ndryshime minimale, ku ndërrojnë vetëm shifrat, struktura buxhetore është e ngjajshme. Ne i kemi ofruar vitin e kaluar njëzet e një propozime, asnjëri prej tyre nuk është marrë parasysh, po vazhdohet me mënyrën e vjetër të trajtimit të projekteve publike, ne ju bëjmë thirrje që propozimet tona të merren parasysh, sepse ato burojnë nga kërkesat e qytetarëve në lagje të ndryshme të qytetit dhe të fshatrave.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2021-2023 është hartuar në bazë të nevojave të komunës, ku secila Drejtori e Komunës i ka vendosur projektet e veta në bazë të kërkesave të qytetarëve, projektet publike të parapara në tabelën numër tetë mund të ndryshojnë edhe gjatë dëgjimeve publike me qytetarë. Buxheti është gjithëpërfshirës ka projekte për secilin vendbanim, andaj ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i kemi shqyrtuar dhe analizuar këto projekte publike dhe e përkrahim për aprovim Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2021-2023. Sëmundja ngjitetëse Covid - 19

siç po shihet do të vazhdon, andaj duhet të shqyrtohen mundësitë buxhetore që të ndahen më shumë mjete financiare për shëndetësinë në vitin e ardhshëm, sepse tani nevojat janë më të mëdha.

Aida Alimi: Unë lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2021-2023 kam diskutuar edhe dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe qëndrimet e njëjta nuk do t'i përsëris. Tani e kemi uljen e buxhetit prej mbi një milion euro dhe ne të gjithë edhe si pozitë, edhe si opozitë, duhet të jemi bashkë dhe të protestojmë, sepse kjo na prekë të gjithëve, ju e dini rritjen e numrit të nxënësve në qytetin tonë, andaj duhet të veprojmë së bashku. Është plotësisht e pa arsyeshme të ndahet një shumë kaq e madhe e mjeteve financiare për shtruarjen e rrugëve me zhavor në buxhet. Kërkesat e Partisë Demokratike të Kosovës ne do t'i paraqesim edhe gjatë kohës së dëgjimeve publike për buxhetin.

Naser Graiçevci: Në buxhet e kemi një përsëritje për njëzet vite, pa asnjë ide të re dhe kreative, pozicionet e njëjta vetëm riciklohen, kjo punë nuk është e rregulltë për zhvillimin e përgjithshëm, ne nuk mund të krenohemi me asnjë projekt, sepse qeverisja lokale nuk po ofron projekte të tilla, po vazhdon me metodën e njëjtë, me qytetin punon shumë pak, bënë projekte, për fshatra dhe klientelën e saj. Puna dhe projektet publike për një qytet në zhvillim si është Fushë-Kosova duhet ta ketë një tjetër dinamikë dhe orientim në projekte më strategjike dhe të qëndrueshme. Te ne po bëhet një shkëmbim i parasë publike me votën e qytetarëve. Nuk mendohet fare për përkrahjen e biznesve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të cilat janë prekur edhe nga pandemia, nuk ka grante për zhvillim dhe punësim, madje për to as nuk po mendohet fare. Në fshatin Sllatinë e Vogël, në zonën te pishat është krijuar një ambient i mirë për qytetarët, por duhet të mendohet edhe për qytetin, të zhvillohen projekte edhe të vogla aty ku ka mundësi, ku e kemi ndonjë hapësirë të vogël që mund ta rregullojmë ambientin me pak investime të komunës. Lidhur me mirëmbajtjen e varrezave të qytetit, ne i vizitojmë ato si qytetarë për festa, për Bajram, por gjendja e tyre është mizere, mungon përkujdesja e komunës, unë sugjeroi që komuna ta ketë një kujdes më të madh për varrezat. Meqë në këtë Kornizë buxhetore nuk ka asgjë të re, ne nuk e përkrahim për miratim, sepse projektet publike janë të njëjta për shumë vite radhazi.

Driton Ademi: Drejtoria e Financave dhe Buxhetit duhet t'iu kushton vëmendje dokumenteve strategjike kur e harton buxhetin, sepse gjithë çka këtu sqarohet në pjesën tekstuale që nuk ndërrohet fare me asgjë konkrete. Korniza Buxhetore duhet të lidhet me Planin Zhvillimor Komunal, duhet të mbështetet në organogramin e të punësuarëve, dokumentet sektoriale e tjera. Në Kornizë objektivat janë të njëjta me të Prishtinës, ndoshta janë marrë edhe nga google, ato barten nga vitet paraprake me kopjim, kjo punë nuk është në rregull, buxheti duhet të jetë kreativ, me projekte të reja dhe objektiva të qarta për zhvillim. Parashihen disa projekte të njëjta për asfaltim, në fshatin Henc është shuma prej: 20,000.00€, për asfaltimin e rrugëve sekondare. Unë sugjeroi që caktimi i prioriteteve për lagje të qytetit dhe fshatra të bëhet përmes diskutimeve publike me qytetarë, por meqë ndryshime në qasje nuk po ka, unë jam kundër aprovimit të kësaj Kornize buxhetore në këtë mënyrë, pa asnjë reflektim të pushtetit, për ndonjë projekt të ri publik.

Mehdi Lahu: Komuna e Fushë-Kosovës edhe për buxhetin e vitit 2021, do të ketë problem, ne shpresojmë që me regjistrimin e popullsisë në vitin 2021, do ta zgjidhim këtë problem dhe do ta marrim buxhetin që na takon, ashtu si jemi në realitet, por ne e dimë se granti në arsim ndahet sipas formulës së njëjtë për gjithë territorin e Kosovës dhe nuk mund ta ndryshojmë ne. Edhe për shëndetësinë vlenë formula e njëjta, sipas numrit të vizitave shëndetësore. Ne kërkojmë që komuna

të merrë parasysh edhe disa kërkesa që shtrohen për zgjidhje praktike nëpër lagje të ndryshme të qytetit, sepse nevojat janë të arsyeshme.

Mirvete Gërguri: Regjistrimi i popullsisë pritet të bëhet vetëm në vitin 2021 dhe nuk mund ta përshtatim në asnjë segment, as lidhur me buxhetimin gjinorë tani. Unë mendoj se komuna duhet të përkrah bizneset që udhëheqen nga gratë. Po ashtu e kam edhe një kërkesë, që të ndahet në shumë e mjeteve financiare për investime edhe në pjesën e fshatit Bardh i Madh në zonën e pishave, të rregullohet infrastruktura.

Migjen Kolshi: Shumica e qëndrimeve u dhanë paraprakisht nga kolegët dhe unë nuk do t'i përsëris, sepse ato do t'i paraqesim edhe në diskutimet publike për buxhetin, por do të ndalem te disa zëra buxhetorë. Për fshatin Harilaç unë kërkoj që të përkrahen vetëm dy projekte rregullimi i rezervuarit të ujit dhe rrethoja e varrezave. Nuk pajtohem që për asfalte dhe zhavor të ndahen shuma e mjeteve financiare prej: 700,000.00€, pastaj për subvencione në Zyrën e Kryetarit të Komunës të jenë 40,000.00€ dhe në Drejtorinë e Financave dhe Buxhetit 35,000.00€, ndërsa te Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit vetëm shuma prej: 35,000.00€, kjo drejtori duhet t'i ndihmon të gjitha klubet e sportit, por kjo punë po dihet viti 2021 është vitë i zgjedhjeve dhe është menduar mirë për këtë punë, që zgjedhjet të fitohen përmes ndarjes së subvencioneve nga Kryetari i Komunës.

Ali Ismaili: Subjekti im politikë Partia e Drejtësisë duke e parë këtë Kornizë buxhetore si fillim të procesit buxhetorë do ta përkrahim, por nëse deri në muajin shtator nuk ka ndonjë ndryshim në bazë të kërkesave të qytetarëve që parashtrohen nga ne këtu dhe ato nuk merren parasysh, ne do të jemi kundër. Këtu u tha me të drejtë se duhet të kemi parasysh edhe lidhjen e buxhetit me dokumentet strategjike nga anëtarë i Kuvendit të Komunës z. Driton Ademi dhe mbi njëzet kërkesa të paraqitura nga Lëvizja Vetëvendosje për ndryshimin e buxhetit, diçka ndonjëra nga këto kërkesa duhet të jetë e pranueshme.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2021-2023'.

U votua me: katërmëdhjetë vota 'për', tetë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2021-2023' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2021-2023, me kufijtë e caktuar buxhetor si vijon:
 - 1.1 Për vitin 2021 buxheti i komunës është në shumë prej: 11,263,819.00€;
 - 1.2 Për vitin 2022 buxheti i komunës është në shumë prej: 12,555,971.00€;
 - 1.3 Për vitin 2023 buxheti i komunës është në shumë prej: 12,852,415.00€.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim: Kërkesën për rritjen e Grantit Qeveritarë për arsim për shumën e mjeteve financiare prej 1,286,153.00€, për Ministrinë e Financave e Transfereve, Ministrinë e Arsimit Shkencës e Teknologjisë dhe Komisionin e Granteve për Komuna.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave i bënë këtë:

Kërkesë për rritjen e Grantit Qeveritarë për arsim për shumën e mjeteve financiare prej 1,286,153.00€, për Ministrinë e Financave e Transfereve, Ministrinë e Arsimit Shkencës e Teknologjisë dhe Komisionin e Granteve për Komuna.

Pika e katërt (4) - Informatë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim 'Informatën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019', të cilën mund ta krahasojmë me vitin 2018. Hap diskutimin.

Driton Ademi: Kjo është informatë me të dhëna e Statcionit Policorë në Fushë-Kosovë, e jo e Informatë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019, andaj nuk kemi çfarë të diskutojmë.

Sabit Bullatovci: Kjo informatë është shumë në rregull, por policia duhet të vepron në teren, në fshatin tim Miradi e Poshtme, rinia po bredhin rrugë në orë dy të natës, unë e informoi Policinë, përgjigja e tyre është ju rrini i qetë dhe flini, automjetet i ngasin fëmijë, ka vjedhje. Policia duhet të jenë në nivel të detyrës dhe t'i elimonon këto dukuri negative në shoqërinë tonë.

Pika e pestë (5) - Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve për menaxhimin e situatës emergjente shëndetësore për parandalimin e përhapjes së Coronavirusit Covid - 19.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Raportin e shpenzimeve për menaxhimin e situatës emergjente shëndetësore për parandalimin e përhapjes së Coronavirusit Covid - 19, ftoi Drejtorin e Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Sqaroi se ky raport i shpenzimeve në fakt është më shumë informatë, për procedurat e realizuara dhe mjetet financiare të shpenzuara në periudhën mars, prill dhe maj 2020. Në fakt është shpenzuar shuma e mjeteve financiare prej 414,000.00€, sepse këtu hyn edhe shuma prej: 10,000.00€ që janë shpenzuar për blerjen e bukës për komunitetet pakicë. Vendimi i Kuvendit të Komunës e ka lejuar shumën e mjeteve financiare prej 404,000.00€, për këto shpenzime i keni edhe zërat buxhetore si vijon: shujtat e punëtorëve shëndetësorë të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, pako hixhenike, pako ushqimore, blerja e miellit, dezinfektimi i objekteve shëndetësore, këto procedura janë realizuar në bazë të udhëzimeve të nivelit qendrorë. Mjetet financiare janë shpenzuar nga kategoria ekonomike e mallërave dhe shërbimeve 273,000.00€ dhe projekteve kapitale 131,000.00€, tek projektet kapitale mjetet financiar janë marrë nga dy kode: bashkëfinacimi i projekteve dhe rastet emergjente. Ne tani në depo i kemi rezervë edhe 3343 kilogram miell dhe 261 pako ushqimore që mund t'i harxhojmë për kërkesat e qytetarëve në nevojë. Ne i kemi gjashtë regjistrator me shënime për qytetarët që janë ndihmuar, me emër e mbiemër, me numër personal, unë i ftoi Shefat e Grupeve Parlamentare, që nëse dëshirojnë mund të shohin dokumentacionin në fjalë. Ne mendojmë se puna dhe procedurat, pastaj shpërndarja kanë shkuar mirë, por edhe ju jeni të lirë të jepni vlerësimet dhe opinionin tuaj, por jo vetëm sa për të thënë diçka pa argumente.

Migjen Kolshi: Ne ju falënderojmë për raportin me numra, me shifra, me emrat e përfituesve të tenderëve, sa mjete financiare janë shpenzuar. Shuma prej 115,000.00€ për dezinfektim është e madhe, ne e dimë se janë dezinfektuar disa hyrje të banesave, rruga 'Dardania', por në fshatra jo,

në fshatin Harilaç jo. Furnizimi me pajisje mjekësore shuma 46,000.00€, këta tender i mbikëqyrë dhe udhëheq Shefi i Zyrës së Prokurimit, i cili i njeh mirë aplikuesit në tender.

Durim Hajra: Raporti të krijon një përshtypje se qytetarëve, rasteve sociale u janë ndarë pako ushqimore, miell e tjera, ky raport në këtë formë është i panevojshëm dhe i padrejtë, ne kemi kërkuar detaje tjera për shpenzimet, punët e kryera dhe përfituesit e ndihmave nga komuna. Drejtoria e Financave dhe Buxhetit neve duhet të na jap një raport të detajizuar dhe të krahasueshëm me planifikimin. Komuna e Fushë-Kosovës është e mesme, mjetet financiare në dispozicion janë shpenzuar shumë shpejtë. Pandemisë nuk po i shihet fundi, fondet është dashur të shpenzohen me kujdes dhe me një shtrirje kohore më të mirë.

Ali Ismaili: Mua më brengos fakti si do t'i mbyllin notat mësimdhënësit e shkollës 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë, kjo shkollë duhet të dezinfektohet, pyes, a ka mjete financiare në dispozicion për këtë çështje. Dezinfektimi i hyrjeve të banesave është bërë, këtë e pohojnë edhe banorët e atyre ndërtesave.

Driton Ademi: Në bazë të perceptimit ju e keni propozuar një vendimarrje, dimensionin e të gjitha shpenzimeve me çmime të përafërta, ato mjete financiare nuk është dashur të lejohen ashtu në aspektin juridikë. Për dezinfektim sa mjete financiare janë shpenzuar, po dihet, po nuk ka një sqarim me shifra, sa dezinfektime në teren janë kryerë, sa hyrje të ndërtesave, sa herë gjatë tre muajve. Ne mendojmë se tani jemi në mesin e pandemisë dhe mjetet financiare të lejuara i kemi shpenzuar. Këto shifra mund të jepen në raportet financiare periodike, tremujore dhe gjashtëmujore, unë kam kërkuar që ne të informohemi përmes emailave tone dhe e kemi ofruar edhe ndihmën tonë, ne nuk kemi patur nevojë për leje të qarkullimit, ne jemi përfaqësues të popullit dhe mjafton ID karta e asamblesitit për legjitimin para organeve shtetërore.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Shpenzimet unë i sqarova, ne kemi punuar në periudhën fillestare të krizës emergjente në bazë të udhëzimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik. Ne kemi rënë të hyrave në këtë periudhë për 70%, e kemi patur të drejtën për marrjen e 5% të mjeteve financiare nëpër secilin projekt kapital, por këtë ne nuk e kemi bërë. Kur hyn në shpenzime edhe furnizimi me bukë i komuniteteve pkicë, kjo shumë rritet për 10,000.00€, mbi mjetet e lejuara financiare në shumë prej: 404,000.00€ nga Kuvendi i Komunës.


Sabit Bullatovci: Shuma e shpenzuar e mjeteve financiare prej: 414,000.00€ për një kohë kaq të shkurtër nuk është në rregull, tani personat e infektuar në fshatin Miradi e Poshtme nuk po ndihmohen nga komuna. Është kënaqësi e veçantë që ne kemi patur këto mjete financiare në dispozicion për t'i ndihmuar personat në nevojë. Shtabi Emergjentë, në komunën tonë nuk ka qenë sa duhet aktivë, ju po i shihni komunat tjera Kryetari i Komunës së Vushtrrisë është për çdo natë ne televizion, jep sqarime për qytetarët. Bizneset tona janë të mbyllura që nga data 11 mars, ato duhet të ndihmohen nga Komuna dhe Qeveria e Kosovës. Shatabi Emergjentë rrinë brenda, policia del në teren pesë minuta, nuk po mbikëqyren personat e infektuar me Covid - 19. Ne jemi komunë me mbi 50.000 mijë banorë, duhet të kërkojmë financim shtesë nga Qeveria e Kosovës, sepse nevojat për dezinfektim janë të mëdha për objektet arsimore, objektet shëndetësore dhe institucionet tjera lokale, objektin e komunës, objektin e Qendrës për Punë Sociale.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës në fund të diskutimeve konstatoi se Kuvendi i Komunës u informua për raportin financiar, sipas standardeve për raportim të shpenzimeve.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 12:50 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

